



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 4, Datë 29.12.2014

PËR

PËRCAKTIMIN E ÇËSHTJES DHE ZONËS ME RËNDËSI KOMBËTARE NË
PLANIFIKIMIN E TERRITORIT, IDENTIFIKUAR SI KURORA E GJELBËR E
TIRANËS

Në mbështetje të neneve 5, 7, 9, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" dhe të VKM-së Nr. 877, datë 03.10.2013 "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", Vendimit të KKT nr. 3, datë 22.08.2014 "Për miratimin e nismës për përcaktimin e disa çështjeve/zonave të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit", me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës, bazuar në vendimin e AKPT-së me nr.1159 Prot, datë 18.08.2014 dhe në vendimin e KKT-së nr. 3, datë 22.08.2014, "Për miratimin e nismës për përcaktimin e disa çështjeve/zonave të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit".
2. Shpalljen 'zonë e rëndësisë kombëtare' të Kurorës së Gjelbër të Tiranës, sipas kufijve të territorit paraqitur në hartën përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me të gjitha Autoritetet e Planifikimit që preken nga ky vendim, të hartojnë planin e zhvillimit me qëllim rritjen e shkallës së ruajtjes së Kurorës së Gjelbër të Tiranës, sipas zonimit të territorit.
4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të jetë autoriteti përgjegjës për kontrollin e përputhshmërisë me këtë Vendim, të dokumenteve të planifikimit të çdo niveli, që do të hartohen në të ardhmen për "Kurorën e Gjelbër të Tiranës", si edhe dokumenteve të zhvillimit e ndërtimit brenda këtij territori.




5. Agarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, brenda 10 ditëve nga marrja e këtij vendimi, të botojë vendimin në Regjistrin e Integruar të Territorit dhe ta dërgojë atë në adresë të gjithë autoriteteve të planifikimit që ndodhen brenda territorit të Kurorës së Qytetit të Tiranës.

6. Agarkohen Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe të gjitha Autoritetet e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

